



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**Ae.nr.1/20**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Mahir Tutuli dhe Qerim Ademaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses-propozueses së sigurimit NNP “[L...]” me seli në fshatin ..., Komuna Ferizaj, të cilën e përfaqëson me autorizim avokatja “[E.SH]” nga Prishtina, kundër të paditurës-kundërshtarit të sigurimit “[T...]”sh.p.k., me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqësojnë me autorizim avokati “[O.H]” nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës-kundërshtarit të sigurimit e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.C.nr.309/19 e datës 13/11/2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **13/03/2020**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**APROVOHET** e themeltë ankesa e të paditurës-kundërshtarit të sigurimit “[T...]”sh.p.k, me seli në Prishtinë dhe **NDRYSHOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.C.nr.309/19 e datës 13/11/2019 dhe çështja gjykohet si vijon: Refuzohet propozimi i paditëses-propozueses së sigurimit NNP “[L...]” me seli në fshatin ..., Komuna Ferizaj, për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, me të cilën ka kërkuar që t’ia ndaloj të paditurës-kundërshtarit të sigurimit, që t’ia tjetërsoj, fshehë, ngarkoj me hipotekë, barrë reale, qira apo të disponoj me pasurin e theksuar si më poshtë: Lokalet dhe Garazhet në Lamelën nr.1, B+S+P+1, në sipërfaqe prej 1082.44 m<sup>2</sup>, Banesën në Lamelën nr.1, kati 2, në sipërfaqen prej 122.55 m<sup>2</sup>, tipi A, së bashku me terasën në sipërfaqe 24.08m<sup>2</sup>, Banesat në Lamelën nr.5, në katin e 4, nr.16, me sipërfaqe bruto prej 132.18m<sup>2</sup>, Banesën nr.17 në sipërfaqe bruto prej 100.20 m<sup>2</sup>, Banesën nr.18, në sipërfaqe bruto prej 109.80m<sup>2</sup> dhe Banesën nr.19 në sipërfaqe bruto prej 64.74m<sup>2</sup>, të gjitha këto të evidentuara në parcelën katastrale nr...., ZK Prishtinë, të gjitha këto në posedim të kundërshtarit të sigurimit “[T...]”sh.p.k, me seli në Prishtinë.

## **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin ankimor IV.EK.C.nr.309/19 e datës 13/11/2019, në piken I të dispozitivit ka vendosur të miratoj propozimin e paditëses-propozueses së sigurimit NNP “[L...]” me seli në fshatin ..., Komuna Ferizaj, për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, në piken II të dispozitivit të aktvendimit ka vendosur që t’ia ndaloj të paditurës-kundërshtarit të sigurimit, që t’ia tjetërsoj, fshehë, ngarkoj me hipotekë, barrë reale, qira apo të disponoj me pasurin e theksuar si më poshtë: Lokalet dhe Garazhet në Lamelën nr.1, B+S+P+1, në sipërfaqe prej 1082.44 m<sup>2</sup>, Banesën në Lamelën nr.1, kati 2, në sipërfaqen prej 122.55 m<sup>2</sup>, tipi A, së bashku me terasën në sipërfaqe 24.08m<sup>2</sup>, Banesat në Lamelën nr.5, në katin e 4, nr.16, me sipërfaqe bruto prej 132.18m<sup>2</sup>, Banesën nr.17 në sipërfaqe bruto prej 100.20 m<sup>2</sup>, Banesën nr.18, në sipërfaqe bruto prej 109.80m<sup>2</sup> dhe Banesën nr.19 në sipërfaqe bruto prej 64.74m<sup>2</sup>, të gjitha këto të evidentuara në parcelën katastrale nr...., ZK Prishtinë, të gjitha këto në posedim të kundërshtarit të sigurimit “[T...]”sh.p.k, me seli në Prishtinë, mandej në piken III të dispozitivit të aktvendimit ka vendosur që kjo masë e sigurisë, mbetet në fuqi deri në vendimin e ardhshëm gjyqësor, me të cilin do të ndryshohet apo hiqet kjo masë siguruese dhe në piken IV të dispozitivit ka vendosur të obligon Zyrën Kadastrale në Komunën e Prishtinës si dhe Shërbimin Noterial me seli në Prishtinë, që lidhur me caktimin e kësaj mase, gjegjësisht vendosjen e kësaj mase si në paragrafin 2 të këtij dispozitivi të evidentojnë në regjistrat përkatës të tyre.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor, ankesë ka paraqitur e paditura-kundërshtari i sigurimit, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore duke kërkuar nga Gjykata e Apelit që aktvendimin ta ndryshoj dhe të refuzoj propozimin për caktimin e masës së sigurisë.

Paditësja-propozuesja e sigurimit ka dhënë përgjigje në ankesë duke propozuar Gjykatës së Apelit, që të refuzon ankesën e të paditurës-kundërshtarit të sigurimit si të pa bazuar dhe të vërtetoj aktvendimin e ankimuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 208 dhe nenin 209 pika c) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

## **-Ankesa është e themeltë.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja-propozuesja e sigurimit NNP “[L...]”, me seli në fshatin ..., Komuna Ferizaj, pran Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me datën 06/06/2019, ka paraqitur padi me propozim për caktimin e masës së sigurisë, kundër të paditurës-kundërshtarit të sigurimit “[T...]”sh.p.k., me seli në Prishtinë, për anulimin e hipotekës nga deklarata-marrëveshja nga veprimtaria afariste, për pasurim të pa bazë, për kthim të sendit/paluaajtshmeris dhe për kompensim dëmi, me propozim për caktimin e masës së sigurisë të precizuar si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së seancës dëgjimore duke vendosur në lidhje me propozimin për caktimin e masës së sigurisë, ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, duke e aprovuar propozimin e propozuesit të masës së sigurisë dhe aktvendimin e atakuar e ka bazuar në dispozitën e nenit 297 par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe si i tillë nuk mund të pranohet, pasi që aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të nenit 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 297 të LPK-së dhe me vlerësim ndryshe të shkresave të lëndës ka konstatuar gjendje tjetër faktike nga ajo e përmbajtur në aktvendimin e atakuar dhe vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi për këto arsye si vijon:

Kolegji i Gjykatës së Apelit, i ka analizuar pretendimet ankimore të propozueses së sigurimit në raport me provat që gjenden në shkresat e lëndës erdh në përfundim se gjykata e shkallës së parë gjatë vendimmarrjes nuk i ka vlerësuar drejtë dhe në mënyrë të plotë të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës, respektivisht në bazë të përgjigjes në kërkesë nga Komuna e Prishtinës e datës 17/07/2019, rezulton se në sistemin kadastral nuk posedon të dhëna pa e pasur numrin identifikues të njësisë banesore ndërsa sa i përket parcelave në të cilat evidentohen të ndërtuara njësit kadastrale të lartshënuar në regjistrin kadastral evidentohet si parcelë me nr.... ZK Prishtinë në pronësi të P.SH. “[Q...]”, prandaj masa siguroese është mjet për parandalimin e ndryshimit të gjendjes ekzistuese të kërkesëpadsisë dhe kjo masë mund të caktohet po që se propozuesi i masës e bënë të besueshme të drejtën e tij subjektive dhe paraqet prova apo rrethana që e bindin gjykatën se pa caktimin e masës së sigurisë ekziston rreziku serioz se kundërshtari i sigurimit me veprimin apo mos veprimin e tij mund t`ia pamundëson apo vështirëson dukshëm realizimin e kërkesëpadsisë. Në rastin konkret propozuesja e masës së

sigurimit nuk ka ofruar ndonjë provë konkrete se kundërshtari i sigurimit vërtet mund të pamundësoj apo vështirësoj dukshëm realizimin e kërkesëpadisë në ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do mund të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozueses të sigurimit ngase këto prona nuk janë të regjistruara në librat kadastral.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se nga vlerësimi i provave që gjenden në shkresat e lëndës ka gjetur se nuk janë përmbushur konditat ligjore të parapara me dispozitën e nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së, për caktimin e masës së sigurisë.

Prandaj, bazuar në të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208 dhe 209 pika c) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**-Departamenti për Çështje Ekonomike-**  
**Ae.nr.1/20, me datën 13/03/2020**

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari  
Liridon Maloku, d.v